- Mbetjet teknologjike te grumbullohen dhe te ambalazhohen sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar per menaxhimin e integruar te mbetjeve.
- Te realizohet ndriçimi perreth objektit dhe sheshit te levizjes se mjeteve.
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te respektoje te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne objekt dhe te respektoje rregulloren e MKZ.
- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impakti per aksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme.

- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perparasite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

- **Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te linjes se prodhimit.**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e impiantit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit te linjes se prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në menyrë të përmbledhur si më poshtë.

1. Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes se prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve.
2. Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier te mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve.
3. Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi i mbetjeve
4. Kapja dhe trajtimi i grimcave te pluhurit
5. Menaxhimi sa me eficient i lendes se pare.
6. Mirembajtja nderrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes se tyre.
7. Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti per prodhimin dhe lyerjen e mobiljeve.
8. Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.

**Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:**

- Parandalimi i shkarkimeve te lendes pare ne mjedis.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve urbane.
- Sasia magazinuese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te mos demtoje instalimin.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.

**Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit dhe lyerjes së mobiljeve:**

- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve dhe sasinë e gjeneruar nga instalimi
- Mbetjet të Rikuperohen, Riciklohen dhe Riperdoren perseri në linjen e prodhimit, ajo sasi e mbetjeve që nuk mund të riciklohet të rikuperohet dhe të asgjësohet nga subjekte të licencuara.
- Investitori të respektojë detyrimet që do të vendosen në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM/MTM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit dhe lyerjes së mobiljeve.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesisë Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.


**MONITORIMI**

**Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit**

Rolin dhe përgjegjësinë kryesore të monitorimit dhe rehabilitimit të mjedisit e ka investitori, ose në rast delegimi të zbatimit të punimeve, subjekti ndertues/nëkontraktor. Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM), Struktura Përgjegjëse Inspektuese për Mjedisin (ISHM), Njësia e Qeverisjes Vendore (NJQV), Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si dhe vete subjekti investitor ose nëkontraktori i zgjedhur për këto qëllime.

Paraqitja në formë skematike e zinxhirit ndër-institucional përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e punimeve ndertimore dhe të rehabilitimit.





### Monitorimi i elementeve mjedisore.

Monitorimi i cilesise se mjedisit dhe i nivelit te elementeve ndotes se tij, shkarkimet ne ajer, ne uje, ne toke dhe demtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore per sa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizimit te mostrave te ujit dhe te tokes, ndersa per sa i perket ndotjes se ajrit ai monitorohet direkt ne terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e te dhenave te nevojshme per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione midis lidhjes se kushteve te burimeve te ndotjes dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor ose ekonomik, me synim per te marre masat e nevojshme per reduktimin e shkarkimeve dhe permiresimin e cilesise se elementeve te mjedisit.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore te hartuara dhe te ndermarra.

Procesi i monitorimit ne rang individual, sipas ligjit per mbrojtjen e mjedisit, eshte detyre e shoqerise investitore/operatorit te pajisur me leje mjedisi ose e nenkontraktorit te zgjedhur per kete qellim, per elementet ne te cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189, date 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund te monitorohen nga vete investitori. Monitorimi te kryhet per shkarkimet ne ajer, zhurmat, cilesine e burimeve ujore, si dhe per punimet e rehabilitimit.

Bazuar ne Ligjin Nr 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Kreu VI, Monitorimi i Gjendjes së Mjedisit, Seksioni 2, Monitorimi i Përputhshmërisë, Neni 44, Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë janë:

- Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
- Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.
- Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.
- Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

### Procesi i Monitorimit

#### Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, kreu VI "monitorim i gjendjes së mjedisit";
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

#### Baza ligjore për monitorim

Ligji Nr.162/2014	Për mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
VKM Nr. 412, datë 19.6.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet sipas kuadrit ligjor, ku operatori i nje leje mjedisi te tipit B, duhet te kryej vetemonitorimin e ndikimeve ne mjedis te aktivitetit dhe i raporton ato rregullisht te pakten dy here ne vit prane AKM-se. Gjithashtu, raportimi periodik permban edhe informacion per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit.

**ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME**

"Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)" është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundur, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

Për qëllime të këtij përkufizimi, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- "Teknikë" është teknologjia dhe mënyra me të cilën instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe çmontuar;

- "Teknikë e disponueshme" janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi;

- "Më e mirë", në lidhje me teknikat, është teknika më efektive për arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.

Aktiviteti objekti i kësaj leje mjedisore, sipas deklarimit të investitorit, ka dhe zbaton teknikat me të mira të disponueshme për këto lloj instalimi.

**PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT**

Sipas deklarimeve të subjektit investitor, do të aplikohen vazhdimisht teknologjite dhe metodat me të mira të disponueshme, do të përdoren mjete dhe materiale miqësore me mjedisin, do të menaxhohen të gjitha mbetjet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, do të aplikohet efikasiteti dhe larte energjie, do të reduktohen shkarkimet në mjedis përmes metodave të kontrollit dhe masave për minimizimin e impakteve, etj.

**PËRSHKRIMI I MASAVE TË TJERA PARANDALUESE TË PLANIFIKUARA**

**Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit të mobiljeve:**

- Të shmangët në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve dhe sasinë e gjeneruar nga instalimi
- Mbetjet të rikuperohen, riciklohen dhe ripërdoren perseri në linjen e prodhimit, ajo sasi e mbetjeve që nuk mund të riciklohet të rikuperohet dhe të asgjësohet nga subjekte të licencuara.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.

- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimzohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

### **Masa lehtësuese të tjera të kërkuara**

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianiti me eficientë.
- Subjekti të kryej aktivitetin për prodhimin e mobiljeve vetëm brenda kordinatave të siperfaqes se pronës/ndertesës qe disponon ne pronesi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet, emetimin e pluhurave, ujrave dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga proceset e prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve.
- Linja e Impiantit të prodhimit te mobiljeve te instaluar në objekt, do të koluaidohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientës që kanë në kryerjen e operacioneve te prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve
- Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, jane të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në menyrë që të jetë i



mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.

- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në linjen e prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve.

**REHABILITIMI, NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË, RIFILLIMI DHE KONTROLLI PAS NXJERRJES NGA PËRDORIMI**

Nderprerja perfundimtare e veprimtarise, apo transferimi i aktivitetit ne nje vendodhje tjeter, sjell si rrjedhoje nevojën për mbylljen dhe rehabilitimin e mjedisit. Ne lidhje me kete hartohet nje plan për mbylljen dhe rehabilitimin qysh ne faze te hershme kur operatori pajiset me leje mjedisi dhe e rishikon ate ne momentin e mbylljes dhe zbatimit te ketij plani. Ne lejen mjedisore te tipit B, ky proces parashikohet ne kushtin nr. 14 te lejes se mjedisit. Plani i mbylljes dhe rehabilitimit konsiston ne keto procese: Çmontimi i pajisjeve/makinerive, transporti i tyre ne vendodhjen e re, ose për ne pikat e riciklimit/asgjesimit ne rast se nuk do te riperdoren. Instalimi ne vendodhjen e re ne rast se aktiviteti transferohet.

Objekti ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti, eshte objekt ekzistues, eshte ne gjendje te mire dhe plotesisht funksional, nuk do te kryhet rikonstrukcion dhe ne rast çmontimi, nuk do te kete prishje te objektit dhe rehabilitim te mjedisit natyror. Gjate zhvillimit te aktivitetit subjekti nuk do te kryej asnje nderhyrje ne strukturen e objektit. Nuk do te kete mbyllje dhe rehabilitim te objektit. Do te kete vetem cmontim dhe largim te pajisjeve.

<b>Preventivi i mbylljes se aktivitetit, çmontimit dhe rehabilitimit</b>		
<b>Nr. zerave te punimeve</b>	<b>Zerat e punimeve</b>	<b>Kosto financiare</b>
<b>1</b>	<b>Kosto çmontimi</b>	_____ leke
<b>2</b>	<b>Kosto transporti</b>	_____ leke
<b>3</b>	<b>Kosto rinstalimi</b>	_____ leke

**PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE**

**Plani i Menaxhimit të Mbetjeve**

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "TUR ÇOBO", me vendndodhje Lagjja "Kushtrimi", Rruga "Dëshmorët", Objekt Nr. 5, Vlorë, Vlorë nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për prodhimin dhe lyerjen e mobiljeve gjenerohet një sasi mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga proceset e prodhimit dhe lyerjes se mobiljeve ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, leter, karton, urbane te perziera, etj)
- Mbetje te kutive te bojerave
- Mbetje te tallazhit (pluhur i lendes drusore)

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, reduktimin e mbetjeve nga proceset e prodhimit, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe transportimi periodik të mbetjeve urbane në vendin e caktuar nga njësia vendore, përmes bashkëpunimit me NJQV-në, për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Zonës së Trajtimit të Mbetjeve (ku kryhet dhe asgjësimi përfundimtar i tyre, sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin e Mbetjeve).

Menaxhimi i mbetjeve brenda zonës së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë.

#### **Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:**

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zonës ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera).
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Ripërdorimi në maksimum të mbetjeve, duke rritur efikasitetin e vete linjes dhe reduktimin e kostos për asgjësimin e tyre.
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendëpoztimin e caktuar nga Njësia Vendore.

#### **Synimet:**

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore.
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe ripërdorim).
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e zonës së trajtimit të mbetjeve
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane dhe mbetjeve teknologjike
- Maksimizimi për reduktimin e mbetjeve nga ushtrimi i aktivitetit për prodhimin dhe lëvizjen e mobiljeve
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një efikasitet dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve.
- Asgjësimin përfundimtar dhe maksiminimin e përdorimit të mbetjeve.

#### **PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E NDIKIMEVE NË MJEDIS**

##### **- Shkarkimet në ajër**

Nga proceset e prodhimit dhe lëvizjes së mobiljeve, kemi gjenerimit grimcave të pluhurit të cilat janë karakteristike për veprimtari të tilla. Grimcat e pluhurit gjenerohen në repartet e përpunimit të lëndës së parë dhe në repartin e lëvizjes. Shoqëria ka marrë masat e nevojshme që në secilin

nga proceset që realizohen të mundesojë kapjen e pluhurave dhe dergimin e tyre në impiantin e trajtimit i cili ndodhet në hyrje të objektit.

- **Shkarkime në ujera**

Një ndikim tjetër i pranishëm në objektin ku zhvillohet aktiviteti është dhe menaxhimi i ujrave, Pavarishtë se procesi i lysterjes kryhet me bojera ekologjike me baze uji, pas disa proceseve prodhimi lind nevoja e parastrimit dhe larjes së ambientit të lysterjes, dhe në këto rast kemi gjenerim të ujrave të cilat grumbullohen nepermjet rrjetit të brendshëm të kanalizimeve dhe orientohen për në pusët dekantuese të shoqërisë e cila shërben edhe si pusët kontrolli. Ujërat e gjeneruara janë me përberje të bojerave ekologjike të cilat shpërbehen në prani të ujit dhe nuk janë të demshme për mjedisin ujor prites.

- **Gjenerimi i zhurmave**

Proceset perpunimit të lëndës së parë drusore dhe montimit të aksesoreve shoqërohen me gjenerim të zhurmave. Proceset zhvillohen teresisht brenda objektit dhe janë të ndara në reparte të caktuara. Pajisjet dhe makineritë janë bashkëkohore dhe janë të montuara në bazamente gize të cilat mundesojnë shuarjen e vibrimeve dhe eliminimin e zhurmave. Zhurmat janë të kontrolluara dhe gjenerohen vetëm brenda reparteve të prodhimit. Operatori në mënyrë periodike kryen mirëmbajtjen e instalimeve për arsye se gjenerimi i zhurmave mbi normat e lejuara prezumon se instalimet/makineritë kanë defekte dhe kërkohet nderhyrja e menjehershme e tyre.

- **Mbetjet teknologjike**

Nga procesi i prodhimit dhe lysterjes së mobiljeve kemi gjenerim të mbetjeve. Natyrë e mbetjeve është e parrezikshme. Mbetjet që gjenerohen në repartin e perpunimit të lëndës drusore të cilat janë copa druri grumbullohen në konteniere metalike me qëllim ripërdorimin e metejshëm të tyre duke prodhuar mozaikë të ndryshëm me copa druri të cilat kërkohen nga kliente të ndryshëm për dekorime të brendshme. Ndërsa mbetjet e tallazhit të cila gjenerohen nga pluhurat e kapura nga impianti i trajtimit të pluhurave shkarkohen direkte në thasë BIGBAGS dhe magazinohen përkohesisht me qëllim dergimin e tyre drejt operatoreve të licencuar për prodhimin e pelletit për ngrohje. Mbetjet e kutive të bojerave magazinohen në konteniere metalike dhe dërgohen drejt operatoreve të licencuar për trajtimin/asgjësimin e metejshëm të tyre.

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet që gjenerohen nga proceset e prodhimit dhe lysterjes së mobiljeve, si dhe nga aktiviteti i perditshme i aktivitetit të punonjësve konsistojnë në gjenerimin e mbetjeve urbane nga punonjësit. Mbetjet urbane grumbullohen në fraksione të ndara duke përdorur sistemin me tre kosha të 1-leter dhe karton, plastike, 2-amabalazhe etj dhe 3- të perziera urbane.

- **Ndikimi në toke**

Proceset e punës nuk do të ndikojnë në toke, pajisjet dhe makineritë janë të izoluara dhe të projektuara në mënyrë të tillë që mos të kemi rrjedhje në toke. Nuk ka përdorim dhe magazinim të lëndëve të rrezikshme. Objekti është ekzistues dhe i pajisur me të gjitha lejet dhe aktet e kontrollit përkatës.

- **Ndikimi në Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e ndjeshme të zonave të mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Aktiviteti ndodhet në zone të urbanizuara dhe nuk ka shtrirje në natyrë.

- **Ndikimi në Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit te banoreve te zones dhe ofrimit te sherbimit per mobilje, duke qene se ne zonen ne fjale nuk ka nje te tille.

▪ **PËRMBLEDHJEN JOTEKNIKE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS NË NIVEL KOMBËTAR OSE NDËRKUFITAR, KUR KËRROHET PROCEDURA E VNM-SË;**

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet perfshihet ne listat e aktiviteteve te cilat duhet te pajisen me leje mjedisore te tipit B, por nuk listohet nder aktivitetet te cilat duhet ti nenshtrohen procedures se VNM Paraprake ose te thelluar.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

(Ref. Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, dhe Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar.).

▪ **KONSULTIMET NDËRKUFITARE, KUR KËRROHET SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI;**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushte normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje. Per kete projekt nuk kryhen konsultime nderkufitare.





- **AUTORITETIN VENDIM-MARRËS PËR DHËNIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË DO TË NDIQEN;**

**Autoritetet vendim-marrese per lejen e mjedisit te tipit B jane Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.**



**Afatet dhe procedurat per lejen e mjedisit te tipit B, janë sipas Kreut III, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 10 e VKM nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.**

### KREU III

#### PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRCAKTIMI I KUSHTEVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B.

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit";
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNMnë e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit B.

10. Afati total për publikimi e vendimit të miratimit ose refuzimit të aplikimit për pajisjen me leje mjedisi të tipi B në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, nga data e marrjes së aplikimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, është 40 (dyzet) ditë pune.

- **ADRESËN E AKM-SË, KU PUBLIKU MUND TË DËRGOJË KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORMË ELEKTRONIKE, BRENDË 20 (NJËZET) DITËVE NGA DATA E NJOFTIMIT.**

Web:

<https://akm.gov.al>

Poste elektronike Email:

[info@akm.gov.al](mailto:info@akm.gov.al)

Adrese postare:

[Tiranë, rruga "Sami Frashëri", Nr. 4,](#)